
LOCAL TAXES IN THE FUNCTION OF LOCAL ECONOMIC DEVELOPMENT - MUNICIPALITY OF PRIZREN

Qëndrim Susuri

University “Ushkin Hoti”, Prizren, Republic of Kosovo, qendrimsusuri@gmail.com

Abstract: Taxes have a role in the implementation of economic and social objectives by local government to create a favorable business environment. The Municipality of Prizren has about 5,200 open businesses that carry out their activity within the territory of the municipality and with their taxes fill the budget of the municipality. Revenues that the municipality generates through businesses place them in function of local economic development indirectly by helping businesses to create an environment suitable for local businesses. One negative feature that has been noted during this research is that businesses registered in Prizren municipality are plagued by large businesses who are registered in other cities of Kosovo because they do not pay the business tax in the municipality of Prizren and this at the same time has a negative effect on local businesses as they are subject to tax on the firm while businesses registered from other cities do not pay this tax when the revenues from the firms' taxes in the municipality of Prizren are quite high.

Municipality of Prizren is not helping businesses to develop the economy through tourism. During 2018 it has allocated subsidies to businesses that promote and influence tourism development only 5,000.00 Euros. While the expenditures allocated to the Capital Investment category in the Directorate of Tourism are realized only 13% of the allocated revenues.

Keywords: Taxes, Development, environment, businesses, tourism

TAKSAT DHE TATIMET LOKALE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL – RASTI KOMUNËS SË PRIZRENIT

Qëndrim Susuri

Universiteti i Prizrenit “Ushkin Hoti”, qendrimsusuri@gmail.com

Abstrakti: Taksat dhe tatimet kanë një rol kyç në implementimin e objektivave ekonomike dhe sociale nga qeverisja lokale për krijimin e një mjedisi të favorshëm ekonomik të bizneseve. Komuna e Prizrenit ka rreth 5,200 biznese të hapura të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të komunës dhe me taksat e tyre mbushin arkën e buxhetit të komunës. Të hyrat që komuna realizon përmes bizneseve ato i vë në funksion të zhvillimit ekonomik lokal në mënyrë indirekte duke ndihmuar bizneset në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për bizneset lokale. Një veçori negative që është vërejtur gjatë këtij hulumtimi kemi ardhur në konstatimin se bizneset e regjistruara në komunën e Prizrenit janë të ngulfatura nga bizneset e mëdha të cilët janë të regjistruara në qytetet e tjera të Kosovës sepse nuk paguajnë taksën e bizneseve në komunën e Prizrenit dhe kjo njëkohësisht ka efekt negativ për bizneset vendore pasi që ata ngarkohen me taksa mbi firmën ndërsa bizneset e regjistruara nga qytetet tjera nuk e paguajnë këtë taksë kur të hyrat nga taksat e firmave në komunën e Prizrenit janë mjaft të larta. Komuna e Prizrenit nuk po ndihmon bizneset në zhvillimin e ekonomisë përmes turizmit. Ajo gjatë vitit 2018 ka ndarë subvencione për bizneset që promovojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e turizmit vetëm 5,000.00 Euro. Ndërsa shpenzimet e ndara për kategorinë e investimeve kapitale në drejtorinë e Turizmit janë realizuar vetëm 13% të të hyrave të alokuara.

Fjalët kyçe: Taksat, zhvillimi, mjedisi, bizneset, turizmi

HYRJE

Shteti dhe komunitetet lokale duhet të kenë një politikë aktive të taksave dhe tatimeve për të kontribuar në arritjen e objektivave të tyre ekonomike dhe sociale, ku ata duhet të gjejnë një masë adekuate për të mos rrezikuar parimet ekonomike dhe të tregut e duke krijuar një mjedis të favorshëm ekonomik⁷³. Politika e taksave përfshin funksionimin e harmonizuar të institucioneve shtetërore nëpërmjet ndikimit të të ardhurave publike në shpërndarjen, shkëmbimin, konsumin dhe prodhimin në një të dhënë për hapësirën kombëtare dhe kohën në përputhje me qëllimet dhe

⁷³ Local Tax Policy in the Function of Development of Municipalities in Serbia - Jugoslav Aničić a *, Miloje Jelić b , Jasminka M. Đurović .

objektivat e pranueshme të shoqërisë. Një gamë e gjerë e ndikimeve të instrumentet e politikës tatimore kontribuojnë me zbatimin e tyre të realizimit të tri funksioneve thelbësore.. Politika e taksave është një instrument i kontrollit dhe rregullave të sjelljes në ekonominë dhe komunitetin lokal. Qyteti i Prizrenit që shtrihet në pjesën jugore të Rrafshit të Dukagjinit, e që zë një sipërfaqe prej 640 km² ose 5.94 % të territorit të Kosovës,

Komuna e Prizrenit renditet si e dyta në Kosovë për nga sipërfaqja. Kjo komunë ka 76 vendbanime dhe ka 174.300 banorë nga të cilët në Prizren jetojnë rreth 110,000 banorë. Për shkak të ngjarjeve që datojnë që nga Lidhja e Prizrenit dhe monumenteve të shumta me karakter kombëtar, Prizreni simbolikisht njihet edhe si kryeqyteti i të gjithë shqiptarëve. Në shekullin XIX Prizreni ishte qendra e dytë më e rëndësishme ekonomiko - tregtare e trojeve shqiptare me rreth 1,500 dyqane. Sot, Prizreni është ndër qytetet më të frekuentuara për nga numri i turistëve për shkak të trashëgimisë së shumë objekteve me karakter kulturo-historik sikurse kompleksi i Shadërvanit, Nënkalaja, Marashi, Kalaja, Kisha e Shën Premtës, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia e Sinan Pashës, Hamamet e qytetit, krojet e qytetit, ura e gurit dhe një numër i madh i shtëpive folklorike të qytetarëve të trashëguar ndër shekuj.⁷⁴

TË DHËNA DHE METODOLOGJIA

Qëllimi këtij hulumtimi është analizimi i procesit të ndikimit të taksave në zhvillimin ekonomik lokal me anë të shpërndarjes së shpenzimeve kapitale në zhvillim ekonomik kryesisht në zhvillimin e turizmit.

Hulumtimi në lidhje me ndikimin e taksave komunale në zhvillimin ekonomik lokal bazohet në analizat fundamentale.

Metodologjia e përdorur për këtë punim janë të dhënat empirike dhe të dhënat nga autoritetet zyrtare të komunës së Prizrenit.

Të hyrat komunale realizohen në bazë të ligjit mbi financat e pushtetit lokal, rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat komunale, rregullores mbi tatimin në pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetjake komunale.

Bazën e të hyrave komunale të Prizrenit e përbëjnë :

Taksat komunale paraqesin ato të hyra, të cilat duhet shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës komunale.

Të hyrat nga taksat komunale të cilat përbëhen nga:

- o Tatimi në pronë
- o Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- o Taksat për lejen për shërbime profesionale
- o Taksa për automjete motorike o Taksa administrative komunale
- o Taksa për leje ndërtimi
- o Taksa për certifikata
- o Taksa për menaxhimin e mbeturinave
- o Qiraja nga objektet o Bashkë-pagesat në arsim
- o Bashkë-pagesat në shëndetësi
- o Renta e tokës

Të hyrat nga ngarkesat komunale

- o Të hyrat nga qiraja
- o Bashkëpagesat në arsim
- o Bashkëpagesat në shëndetësi

Të hyrat e tjera

- o Të hyrat nga aktivitetet tjera të komunës⁷⁵

Të hyrat vetanake totale të komunës gjatë vitit 2018 ishin **8,121,284.⁰⁰ €** ku prej tyre **2,150,000.⁰⁰ €** ishin nga taksat e tatimit në pronë dhe **4,761,284.⁰⁰ €** nga taksat tjera komunale.⁷⁶

⁷⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Prizrenit

⁷⁵ Korniza-afatmesme buxhetore e komunës së Prizrenit , fq. 10.

⁷⁶ Buxheti komunës së Prizrenit për vitin 2018; fq.4

Tabela 1.

VITI 2018			
TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	€ 8,121,284.00		
Të hyrat nga tatimi në pronë	€ 2,150,000.00		
Të hyrat nga taksat komunale	€ 4,761,284.00		
		<i>Licencat dhe lejet</i>	<i>€ 350,000.00</i>
		<i>Çertifikatat dhe dokumentet</i>	<i>€ 500,000.00</i>
		<i>Taksat e paisjeve motorike</i>	<i>€ 850,000.00</i>
		<i>Lejet për ndërtesa</i>	<i>€ 1,411,284.00</i>
		<i>Taksat nga menaxhimi mbeturinave</i>	<i>€ 1,400,000.00</i>
		<i>Taksat tjera komunale</i>	<i>€ 250,000.00</i>
Ngarkesat komunale	€ 1,040,000.00		
		<i>Të hyrat nga qiraja</i>	<i>€ 700,000.00</i>
		<i>Bashkëpagesat në arsim</i>	<i>€ 120,000.00</i>
		<i>Bashkëpagesat në shëndetësi</i>	<i>€ 220,000.00</i>
Të hyrat tjera	€ 170,000.00		

Në komunën e Prizrenit afarojnë veprimtari të ndryshme afariste, përfshirë ndërmarrjet e vogla e të mesme të cilat janë rreth **5,200** biznese.⁷⁷ Viti 2018 është karakterizuar me rënie të qarkullimit në veprimtaritë afariste të Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në Qendrën Komunale të Biznesit janë evidentuar **184** raste të shuarjes së biznesit, kryesisht dyqane tregtare. Numri i bizneseve të shuara megjithatë është më i ulët krahasuar se në vitin 2017, kur në Prizren ishin shuar afro **220** biznese. Numri më i madh i bizneseve është shuar gjatë shtatorit, gjithsej **26** sosh, derisa në gusht më pak apo vetëm gjashtë biznese.⁷⁸

Ndër arsytet të cilat pronarët i kanë përmendur në formularin përkatës të QKB-së është rënia e qarkullimit ekonomik, që padyshim se është reflektuar në afarizmin e bizneseve të ndryshme, duke shtyrë ata ta bëjnë mbylljen e dyqaneve në mënyrë vullnetare. Në anën tjetër numri i bizneseve të reja të regjistruara në QKB gjatë vitit të kaluar ka qenë **771** sosh, apo **76** më shumë se në vitin 2017 kur ishin regjistruar **665** biznese të reja. Një karakteristikë e mbledhjes së të hyrave nga taksat komunale janë se gjatë vitit 2018 komuna e Prizrenit ka arritur të realizoj të hyra nga bizneset ndërtimore në vlerë prej **1,411,284.00 €** që nënkupton se komuna dita e ditës po ndërtohet me objekte të reja afariste apo banimi nga kompanitë kryesisht lokale.⁷⁹

Pas mbledhjes së të hyrave komunale rritja e ekonomisë lokale synohet të realizohet përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirsim, bursa për studime, laboratore).
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë
- Zhvillimi i strategjisë Komunale për promovim ekonomik sidomos në sektorin e hotelierisë.
- Krijimi i kushteve për investime të huaja .
- Strategjia për zhvillimin rural.

Programet për realizimin e synimeve për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Prizrenit janë:

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë

- Përmirësimi i politikës së prokurimit dhe procedurat
- Shënimet e duhura financiare dhe procedurat e kontabilitetit
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës
- Koordinimet në mes departamenteve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat
- Menaxhimi i bazës së të dhënave dhe përhapja e informatave

b. Përmirësimi i bazës së të ardhurave

- Arkëtim më të madh të tarifave dhe ngarkesave që janë për t'u paguar

⁷⁷ https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Prizrenit

⁷⁸ [Raporti i Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e bizneseve në Kosovë për periudhën Tetor-Dhjetor 2018](#)

⁷⁹ <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/10/BUXHETI-I-KOMUNE-S-PRIZRENIT-Per-JANAR-SHTATOR-2018.pdf> fq. 7

- Sa më shumë tatimpagues në rrjetin e tatimeve
- Ngarkesa (çmime) të reja për shërbime të reja
- Çmime (ngarkesa) të ndryshme
- Ngarkesa të reduktuara
- c. Ristrukturimi organizativ
- Shqyrtimi i strukturës organizative .

Tabela 2.⁸⁰

Tabela e shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale për periudhën janar-shtator 2018

Drejtoria	Planifikimi	Alokimi	Realizimi	Realizimi/alok%
Zhvillimi ekonomik – Turizmi	1,312,335	1,125,674	145,731	13%

Komuna ka bërë ndarjen e shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale sipas drejtorive nga janari 2018 deri në shtator 2018 ku këto ndarje në total janë realizuar afërsisht 50%. Në tabelën e mësipërme kemi paraqitur vetëm drejtorinë e zhvillimit ekonomik – turizmit ku shohim se komuna ka treguar një efikasitet të dobët në realizimin e projekteve për zhvillimin ekonomik sidomos turizmin. Një realizim prej 13% paraqet një menaxhim të dobët të mjeteve të alokuara për drejtorinë e zhvillimit ekonomik lokal.

Tabela 3.⁸¹

Pasqyra e shpenzimeve të subvencioneve

Drejtoria e zhvillimit ekonomik

Subvencionet : Drejtoria e turizmit dhe zhvillimit ekonomik

Zhvillimi ekonomik	5,000 €
Mbështetje financiare	3,000 €
Mbështetje financiare për art	1,000 €
Shadërvan SHPM	350 €
Shoq.e grave orkide	650 €

Duke u bazuar në pasqyrën e shpenzimeve të subvencioneve komunale të drejtorisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Prizrenit ka një shpërndarje të dobët të mjeteve financiare për mbështetjen e bizneseve lokale sidomos atyre që promovojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e turizmit. Nga pasqyra e mëposhtme shihet se Komuna e Prizrenit ka ndarë subvencione vetëm 5,000 Euro e cila është një shumë shumë e vogël në krahasim me turizmin që ka qyteti i Prizrenit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga të dhënat e mbledhura për komunën e Prizrenit vërejmë se komuna me anë të politikave të saj zhvillimore nuk po ndikon për zhvillimin ekonomik lokal sidomos sidomos të sektorit të turizmit. Nga të gjitha ndarjet buxhetore dhe alokimet e buxhetit të komunës Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe turizmit ka realizuar një pjesë shumë të vogël të tyre. Kjo paraqet një problem mjaft të madh për bizneset vendore të sektorit të turizmit për arsye se komuna e Prizrenit përmban në vete një numër të madh të bizneseve të sektorit të turizmit duke mbledhur nga ato biznese taksat komunale.

Gjatë analizimit të të dhënave nga Komuna e Prizrenit kemi vërejtur se komuna po i ngarkon bizneset vendore me taksa komunale ndërsa bizneset që hapin bizneset në komunat tjera përmes afarizmit të tyre mbledhin mjetet financiare nga qytetarët e Prizrenit ndërsa pagesën e taksave për bizneset i paguajnë në komunat e tyre.

Fillimisht rekomandohet që komuna e Prizrenit prioritet të ketë turizmin dhe promovimin e tij përmes drejtorisë së turizmit pasi që qyteti i Prizrenit është një ndër qytetet më të lashta dhe ka një numër të konsiderueshëm të vizitorëve.

Poashtu komuna e Prizrenit rekomandohet të bëjë mbledhjen e taksave edhe nga bizneset e komunave tjera duke i taksuar në të njëjtat tarifa sikurse bizneset vendore të komunës së Prizrenit në mënyrë që bizneset vendore të jenë konkurrencte me bizneset tjera.

⁸⁰ <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/10/BUXHETI-I-KOMUNESe-PRIZRENIT-PeR-JANAR-SHTATOR-2018.pdf> fq.12

⁸¹ <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/10/BUXHETI-I-KOMUNESe-PRIZRENIT-PeR-JANAR-SHTATOR-2018.pdf> fq. 23

REFERENCAT

Local Tax Policy in the Function of Development of Municipalities in Serbia - Yugoslav Aničić a *, Miloje Jelić b , Jasminka M. Đurović .

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/07/Korniza-Afatmesme-Buxhetore-2019-2021.pdf>

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/10/BUXHETI-I-KOMUNESe-PRIZRENIT-PeR-JANAR-SHTATOR-2018.pdf>

http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_KPZ_2017_Shqip.pdf

https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Prizrenit

[Raporti i Indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e bizneseve në Kosovë për periudhën Tetor-Dhjetor 2018.](#)